



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1143/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Hajrullah Latifit anetar i subjektit politik Partia Demokratike të Kosovës (PDK) konkretisht kandidat për asamble komunale të komunes së Podujevës, paraqitur kundër Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) pas publikimit të rezultateve përfundimtare për kuvend komunal për shkak të manipulimit të votave gjatë procesit Zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur më 06.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Hajrullah Latifit kandidat për kuvendin komunal të Podujevës nga rradhet e PDK-së dega në Podujevë.

Arsyetim

PZAP-i, më datë 03.12.2013 ka pranuar një ankesë nga Hajrullah Latifit anetare i PDK-së dega në Podujevë konkretisht kandidate për asamble komunale të komunes së Podujevës i cili pretendon në manipulim të votave gjatë procesit zgjedhor edhe konstaton se pas shpalljes së rezultateve preliminare në KQZ të Podujevës në vetëm 60 vendvotime kishte 311 vota kurse me shpalljen e rezultateve përfundimtare kishte 303 vota.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

PZAP-i konstatoi se nga deshmite e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës si dhe nga pretendimet e ankuesit në ankesën e tij se ka ndodhur manipulimi i votave gjatë procesit zgjedhor, vlersohen si të pabazuara dhe të pa argumentuara në prova dhe dëshmi bindëse, siç pretendon pala ankuese në ankesën e saj, andaj ankesa e tillë është e pabazuar dhe se për këtë çështje PZAP-i në mbështetje të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, si dhe dhe nenit 3.6.pika c. vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 1143/2013 më datën 06.12.2013



Këshillë Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*